



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

Nr. 686.Prot.

Peqin, më 24.04.2025

Urdher

Nr. 125 date 24.04.2025

“Per percaktimin e vendeve publike te lejuara per afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore per zgjedhjet e dates 11.05.2025 per Kuvendin e Shqiperise “

Ne mbeshet te ligjit nr.10019 ,date 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise” ,i ndryshuar neni 79 ,Udhezimit te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve Nr.6ndate 23.03.2021,” Per perdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat per afishimin e tyre gjate fushates zgjedhore” i ndryshuar ,

Urdheroj

- 1.Percaktimin e vendeve publike te lejuara ne territorin e Bashkise Peqin per afishimin e materialeve educative zgjedhore ne menyre proporcionale ,hapesire kjo qe siguron shikueshmerine publike.
- 2.Materialet propaganditike zgjedhore dhe sendete lejuara per fushate zgjedhore lejohen te afishohen vetem deri ne nje distance prej 5 (pese) metrash nga zyra zgjedhore e partise politike apo subjektit zgjedhore perkates dhe jo me pare se 30 (tridhjete) dite para dates se zgjedhjeve .
- 3.Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike ne :fasadate ,godinave te banimit ,institucioneve publike apo ambienteve rrethuese prane e rreth tyre,brenda zonave rekreative,parqeve ,ne pemet e qytetit ,shtyllat e ndricimit dhe mjetet qe operojne ne transportin publik.

4. Te gjitha materialet propagandistike vizive qe perdoren ne fushate duhet te shoqerohen me shenimin : "Prodhuar nen pergjegjesine ligjore te " (vijon emri i subjektit zgjedhore)
5. Subjektet zgjedhore duhet te njoftojne me shkrim Kryetarin e Bashkise per hapjen e zyrave zgjedhore me adresat e sakta te tyre , jo me vonë se 35 dite para dates se zgjedhjeve.
6. Subjektet zgjedhore duhet ti permbahen dispozitave te pervcaktuara ne Kodin Zgjedhor dhe Udhezimin e Komisionerit Shteteror te Zgjedhjeve dhe me mbarimin e fushates zgjedhore ,te marin masa per heqjen e te gjitha materialeve propagandistike.
7. Policia bashkiake ngarkohet me detyre per te garantuar zbatimin e ketij vendimi, per te mos lejuar ,per te hequr menjehere cdo material statik perfshire posterat dhe flamujt nga cdo vendndodhje tjeter kur konstatohet qe nuk jane vendosur ne perputhje me kriteret e percaktuara ne Kodin Zgjedhor dhe Udhezimin e Komisionit shteteror te Zgjedhjeve .
8. Ky vendim i dergohet per njohje prefektit te Qarkut Elbasan dhe Drejtorise Vendore te Policise se Qarkut Elbasan.
9. Ky vendim publikohet ne faqen e internetit te bashkise menjehere pas miratimit dhe nje kopje e tij i njoftohet Komisionit Qendror te Zgjedhjeve .
10. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Kryetari I Bashksie

